



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstvo za Obrazovanje, Nauke i Tehnologije-Ministry of Education Science and Technology

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/ Cabinet of the Minister

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Realizimi i programit “Shkrim lexim bazik për gra dhe vajza”

NUMËR:13/2008

DATË: 01.6.2008

Në bazë të Kapitullit VI, neneve 93 (4) dhe 97 (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 42.1 të Ligjit mbi arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë, të neneve 31 dhe 32 të ligjit mbi arsimin dhe aftësimin e të rriturve , Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (më poshtë MASHT), nxjerr këtë Udhëzim Administrativ (më tutje UA):

Neni 1
Qëllimi

Me këtë UA rregullohet realizimi i programit “Shkrim- leximi bazik për gra dhe vajza”.

Neni 2
Regjistrimi

Në këtë program arsimimi mund të regjistrohen të gjitha kandidatet e interesuara, të cilat e kanë kaluar moshën 15 vjeçare e nuk kanë arritur ta përfundojnë shkollën fillore.

Neni 3
Dokumentacioni i nevojshëm

Për regjistrim kandidatja duhet të paraqes, kërkesën dhe certifikatën e lindjes.

Neni 4
Programi arsimor

Përmbajtjet programore janë të përcaktuara dhe të miratuara nga MASHT-i, dhe përfshijnë përmbajtjet programore të nivelit të parë respektivisht të shkollës fillore.

Neni 5
Vendi

Shkollën ose lokalin jashtë shkolle, për organizimin dhe mbajtjen e mësimit, e cakton MASHT-i në bashkëpunim me DKA-në dhe implementuesin e projektit.

Neni 6
Vijimi i mësimit

Kandidatet të cilat synojnë ta vazhdojnë shkollimin e mëtejshëm, janë të obliguara ta realizojnë programin mësimor në tërësi.

Neni 7
Dokumentacioni shkollor

Shkolla e caktuar sipas nenit 5 të këtij UA është e obliguar ta ketë:

1. Dosjen për secilin nxënës, në të cilën ruhet: kërkesa, certifikata e lindjes, testet për vlerësimin e tyre dhe
2. Librin e protokollit.

Neni 8
Certifikimi

Kandidatja e cila e ka mbaruar programin mësimor, pajiset me dëftesë të shkollës fillore.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Ky UA hyn në fuqi me rastin e nënshkrimit të tij.

Enver Hoxhaj, ministër